



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VORË
KRYETAR

Nr. 6068/1 Prot.

Vorë, më 19.12.2025

THIRRJE PËR APLIKIM NË PROGRAMET E STREHIMIT

Bashkia Vorë njofton hapjen e thirrjes për aplikim për qytetarët që dëshirojnë të përfitojnë nga programi social i strehimit: **“Përmirësimi i banesave ekzistuese sipas VKM nr. 454, datë 03.07.2019”**, mbështetur në ligjin nr. 22/2018 “Për strehimin social” dhe akteve nënligjore përkatëse.

➤ Njoftojmë që të drejtën për të aplikuar e kanë familjet ose individët që:

- Disponojnë një banesë;
- Jetojnë në kushte të vështira ekonomike e sociale;
- Plotësojnë kriteret e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi;

➤ Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Certifikatë familjare të rifreskuar në tre muajt e fundit;
- Fotokopje e kartës së identitetit të aplikantit dhe anëtarëve të familjes;
- Çertifikatën e pronësisë mbi banesën ose vërtetim nga ASHK që është në proces legalizimi;
- Vërtetim të statusit social dhe ekonomik;
- Dokumentacion shtesë sipas programit ku aplikohet;

➤ Afatet e aplikimit:

- Afati i hapjes së thirrjes: 20.12.2025
- Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve: 20.01.2026

Aplikimet bëhen në portalin E-albania me asistencën e punonjësve të Bashkisë Vorë.

Sqarim: Për çdo paqartësi ju lutëm të paraqiteni pranë institucionit.

KRYETAR

Blerim SHERA

